

VENDIM
Nr.39, datë 19.9.2011

**PËR PLANIN E DHËNIES SË NDIHMËS SHTETËRORE “PËR MASËN E
FINANCIMIT, KRITERET DHE PROCEDURAT E ZBATIMIT TË PROGRAMIT TË
NXITJES SË PUNËSIMIT TË PUNËKËRKUESVE TË PAPUNË QË HYJNË PËR HERË
TË PARË
NË PUNË”**

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, me pjesëmarrjen e:

- | | |
|----------------------|---------|
| - z. Nasip Naço | Kryetar |
| - znj. Mimoza Dhëmbi | Anëtare |
| - z. Besjan Pesha | Anëtar |
| - z. Zef Preçi | Anëtar |

Në mbledhjen e tij të datës 19.9.2011, shqyrtoi njoftimin e planit “Për programin e nxitjes së punësimit të femrave nga grupet e veçanta”. Njoftimi është bërë pranë Drejtorisë së Mekanizmave të Tregut dhe Ndhmës Shtetërore në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës nga Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta (MPÇSSHB) me shkresën nr.2263 datë 6.12.2010 dhe është regjistruar në Regjistrin e DMTNSH-së me nr. AI/N/11/2011 datë 12.1.2011.

OBJEKTIVI/VAT: Plani për dhënien e ndihmës synon të ndihmojë punëdhënësit të cilët punësojnë për herë të parë të rinj nga mosha 16-25 vjeç, të cilët nuk kanë eksperiencë të mëparshme pune.

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, pasi shqyrtoi raportin e përgatitur nga Drejtoria e Mekanizmave të Tregut dhe Ndhmës Shtetërore dhe gjithë dokumentacionin mbështetës,

VËREN SE:

1. Skema ka si qëllim nxitjen e punësimit të punëkërkuesve të papunë të rinj nga mosha 16-25 vjeç, të cilët nuk kanë eksperiencë të mëparshme nëpërmjet subvencionimit të tyre nga buxheti i shtetit. Kostoja përballohet nga fondet vjetore të miratuara në ligjin për buxhetin e shtetit të vitit përkatës.

2. Kjo skemë ndihme i jep mundësi atyre ndërmarrjeve, projektet e të cilave janë fituese, të financohen nga buxheti i shtetit. Në këtë mënyrë gjatë zbatimit të projektit (skemës së ndihmës) ndërmarrja fituese është duke përballuar një pjesë (pika “a” dhe “c” e projektvendimit) ose të gjithë koston e punës (pika “b” e projektvendimit) nëpërmjet burimeve shtetërore. Duke u dhënë atyre përparësi apo efekt nxitës, të cilin në kushte të tjera nuk do të kishin përfituar.

3. Skema ka karakter për zgjedhës, sepse jo të gjitha ndërmarrjet janë të afta për të aplikuar dhe më pas plotësuar të gjitha kriteret e përfitimit nga kjo skemë.

4. Skema ka efekt në tregti, pasi ka ndikim në veprimtarinë ekonomike të ndërmarrjeve në një treg të caktuar. Gjithashtu skema ka mundësi për të shtrembëruar konkurrencën.

5. Dhënësi i ndihmës është Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.

6. Përfituesit nga skema janë të gjitha ndërmarrjet/institucionet private, që kanë si qëllim marrjen, në punësim me kontratë të rregullt, punëkërkues të papunë të rinj nga mosha 16-25 vjeç, të cilët nuk kanë eksperiencë të mëparshme pune.

7. Skema është e shtrirë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

8. Intensiteti i ndihmës së parashikuar në këtë skemë është brenda kufijve të përcaktuar në nenin 10, shkronja “a” të ligjit “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar, i cili përcakton se “Intensiteti i ndihmës nuk duhet të kalojë 75% të kostove të pagave për punonjësit me aftësi të

kufizuara dhe 50% të kostove të pagave për punonjësit në vështirësi”.

PËR KËTO ARSYE,

Komisioni i Ndhmës Shtetërore, në bazë të nenit 10, shkronja a, nenit 17 shkronja ç të ligjit nr.9374, datë 21.4.2005 “Për ndihmën shtetërore”, të ndryshuar,

VENDOSI:

1. Të miratojë planin “Për masën e financimit, kriteret dhe procedurat e zbatimit të programit të nxitjes së punësimit të punëkërkuësve të papunë që hyjnë për herë të parë në punë”.

2. Punësimi i punëkërkuësve të papunë të rinj nga mosha 16-25 vjeç, të cilët nuk kanë eksperiencë të mëparshme pune duhet të kryhet për plotësimin e vendeve të reja të punës ose vendeve të lira të punës, të cilat janë krijuar si rezultat i largimit vullnetar, daljes në pension apo largimit të ligjshëm dhe jo për shkak të krijimit të vendeve të punës si pasojë e riorganizimit (punonjësit e larguar si të tepërt).

3. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, brenda datës 31 mars të çdo viti të paraqesë pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës:

- raportin për impaktin e ndihmës shtetërore gjatë vitit paraardhës financiar;
- të japë çdo informacion që do të kërkohet për monitorimin dhe kontrollin e ndihmës së dhënë.

4. Të ruajë të gjitha të dhënat për zbatimin e skemës deri në dhjetë vjet, pasi ndihma e fundit individuale të jetë dhënë në kuadër të kësaj skeme.

5. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Nasip Naço